

## **Akt themelimi i**

### **Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara 'PharmaLife Southeast' SH.P.K**

Sot me date 17.09.2024 , dite e marte, pala e mëposhtme:

- Ilza Zoto, atësia Ilia, amësia Rozeta e lindur me 20.10.1979 ne Tirane dhe banuese ne Tirane , madhore , me zotësi te plote per te vepruar, identifikuar me ID nr personal H96020052S

Ka vendosur te nënshkruaj Aktin e themelimit dhe Statutin e nje shoqërie me përgjegjësi te kufizuara aktiviteti i se cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi , bazuar ne Ligjin nr 9901 date 14.04.20018 'Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare' dhe Ligjit nr 9723, date 03.05.2007 'Per qendrën Kombetare te regjistrimit' i ndryshuar.

#### **Neni 1**

##### **Emertimi i Shoqerise**

Emertimi i shoqërisë është 'PharmaLife Southeast' sh.p.k

#### **Neni 2 – Selia**

Selia e shoqërisë është: Tirane , Njesia Administrative nr 2 , Rruga Jeronim De Rada , Nd 1 , H 25 , Ap 28

#### **Neni 3 – Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarisë se shoqërisë do te jete me nje afat te pacaktuar.

#### **Neni 4 - Objekti i Shoqerise**

Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne përputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi. Objekti i aktivitetit do te jete tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike etj. Shoqeria mund te kryej cdo lloj aktiviteti te ligjshëm tregtar import, eksport, tregti me shumice dhe pakice e mallerave. Shoqeria mund te kryeje aktivitet publikimi dhe reklamimi. Gjithashtu shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti tjetër qe mund te konsiderohet i nevojshëm apo i dobishëm ose ndihmës ne përmbushjen e qëllimeve te mësipërme.

#### **Neni 5 - Kapitali i shoqërisë**

Kapitali fillestar i shoqërisë 'PharmaLife Southeast' Shpk do te jete 100.000 leke.Kapitali zotërohet 100 % nga ortaku i vetëm Ilza Zoto. Ky kapital perbehet nga nje kuote qe përfaqëson

100 % te kapitalit me vlere nominale 100.000 leke. Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakësohet.

### **Neni 6 – Drejtimi i Shoqerise**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj. Administrator caktohet Ilza Zoto e cila do te jete dhe përfaqësuesja ligjore e shoqërisë. Ajo eshte përfaqësuesja e shoqërisë ne mardhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj. Cdo kontrate do te kryhet prej saj dhe ne rast mungese nga nje përfaqësues i pajisur me prokure te posaçme. Mandati i administratorit do te jete 5 vite me te drejte riemërimi. Ky mandat fillon nga data 17.09.2024 deri me 17.09.2029.

### **Neni 7 – Kompetencat**

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emër te shoqërisë, ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht asamblesë se ortakeve te shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet nëpërmjet akteve qe janë ne përputhje me objektin e saj.

### **Neni 8 - Viti Financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Regjistrin tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 9 – Shperndarja ose prishja e shoqërisë**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund te behet ne cdo kohe dhe per çfarëdo shkakut edhe para plotësimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene:

- Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit te mëtejshëm te veprimtarisë se saj
- Ne nje nga mënyrat e parashikuara nga Ligji ‘Per falimentimin’
- Kur plotësohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendimin me shkrim ne te cilin parashikon mënyrën e likuidimit te shoqërisë , duke caktuar nje apo disa likuidatorë dhe shënuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese ‘Shoqeri ne likuidim e siper’

### **Neni 10 - Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.01.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare’, Kodi Civil, Ligji per QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

### **Neni 11 – Mosmarrëveshjet**

Per cdo mosmarrëveshje qe mund te lind ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti/akt themelimi dhe per cdo mosmarrëveshje qe mund te lind ndërmjet shoqërisë dhe palëve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

### **Neni 12 -Dispozita Perfundimtare**

Ky akt themelimi/statut i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara ‘PharmaLife Southeast’ shpk hartohet ne 3 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila dhe miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë, nënshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën e tij.

**Ortak i vetëm i shoqërisë**

**‘PharmaLife Southeast ’ Sh.P.K**